



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L-040, neneve 3 paragrafi 2, nenin 4 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ nr.2712012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/16 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, miratoi, *ndryshim plotësimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi sipas Vendimit bazë të Kuvendit të Komunës me nr.prot.01-020/04-0038894/18 të datës 11 maj 2018 përfshirë edhe plotësim ndryshimet tjera pasuese përkatëse, përkatësisht zëvendësimi i anëtarëve sipas funksioneve/pozitave.*

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

(Teksti i spastruar me ndryshime dhe plotësime të miratuara)

Neni 1

Përbërja e këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB, është si në vijim;

- | | |
|--|----------|
| 1. Shpejtim Bulliqi , Kryetar i Komunës, | Kryesues |
| 2. Isak Ejupi , Komandant i Stacionit të Policisë – Podujevë, | anëtar |
| 3. Mensur Hoti , përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Podujevë, | anëtar |
| 4. Radisav Perovic , përfaqësues i komunitetit serb, | anëtar |
| 5. Enver Rama , përfaqësues i komunitetit rom, | anëtar |
| 6. Albina Avdiu , kryesuese e Komitetit për Komunitete, | anëtare |
| 7. Naime Podvorica , zyrtare për Barazi Gjinore, | anëtare |
| 8. Avni Fetahu , drejtor i Drejtorisë së Arsimit, | anëtar |
| 9. Besfort Kruma , përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës – FSK, | anëtar |
| 10. Qefser Behrami , përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Kërprimëh, | anëtar |
| 11. Nuhi Selimi , përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Orllan, | anëtar |
| 12. Rizah Muqolli , kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, | anëtar |
| 13. Fevzi Jetullahu , përfaqësues i Emergjencave Civile, | anëtar |
| 14. Liman Zeqiri , përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, | anëtar |
| 15. Donjetë Sheqiri , përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta, | anëtare |

Neni 2

Mandati i anëtarëve të KKSBB-së të njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 2712012 MPB-03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 4

Për punën e tyre anëtarët e KKSBB-së paguhen nga buxheti i Komunës. Kompensimi bëhet konform nëntit 18 të Udhëzimit Administrativ nr.2712012 MPB-03/2012.

Neni 5

Pas miratimit, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-020/04-0079684/20
Podujevë,
30 dhjetor 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi